

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5822
E martë, 9 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Hapet edicioni
i 19 i Universitetit
Veror të Prishtinës I FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION



NË „KËRKIM“ TË
ALI AHMETIT

Duke marrë shkas nga një letër drejtuar mikut tim,
Ismet Sylejmani, përsiatje për pushtetin, njeriun
dhe artin e vështirë të të jetuarit në paqe.

BEDRI ISLAMI

GJERMANIA, FITUESJA E KOMPROMISIT PËR EVROPËN

F. 11

Auron DODI

AKTUALE

AAK-ja FTON ORGANET E DREJTËSISË TË MERRREN ME KEQPËRDORIMET E KOMUNËS SË PEJËS F. 5

DUDA BALJE: KOSOVA, LIDERE PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT F. 3

EKONOMI

OEK-U DHE UNDCO-S SYNOJNË T'I RRSIN AFTËSITË PËR PUNËSIM F.9

MATOSHI THOTË SE NUK KA FUQI TA NDALOJË NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË SHITËRPECË F.9

KULTURË

NDAHEN ÇMIMET NË FUSHËN E ARTIT PAMOR F. 6

SPORT

FERONIKELI KËRKON REZULTAT POZITIV NË UELL

F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", HAKI RUGOVA I FAQE 4-5



Kjo qeveri s'mund të shkojë më larg se në fillim të vjeshtës

Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Haki Rugova, ka bërë me dije se kjo parti po insiston për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për shkak të keqqeverisjes që po i ndodh vendit. Ai ka thënë se asnjë segment i qeverisjes nuk është duke punuar si duhet dhe, sipas Rugovës, ky

koalicion nuk mund t'i zgjidhë problemet madhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se kjo qeveri nuk mund të shkojë më larg se në fillim të vjeshtës. Rugova ka shprehur optimizëm se LDK-ja do t'i fitojë zgjedhjet dhe do ta qeverisë vendin në mandatin e

ardhshëm. Ai ka folur edhe për zgjedhjet brenda LDK-së duke thënë se rrahjet që e kanë përcjellë këtë proces nuk mund të kenë efekt negativ në elektorat. Rugova nuk e ka mohuar mundësinë që t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së, por ka thënë se duhet të arrihet një marrëveshje paraprake

Taksa, pengesë për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) vazhdojnë të kërkojnë nga Qeveria e Kosovës heqjen e taksës për mallrat serbe. Zyrtarët e lartë amerikanë dhe evropianë kanë thënë se taksa vazhdon të mbetet pengesë për vazhdimin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ambasadori i ShBA-së në Beograd, Kyle Scott, ka thënë të hënën se pa e hequr taksën palët nuk mund të ulen në tavolinë për ta vazhduar procesin e dialogut I FAQE 3



Bëhet gati shtatorja
e Hamëz Jasharit

I FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Opozita mban protestën për largimin e Edi Ramës

TIRANË, 8 KORRIK - Opozita ka mbajtur të hënën në mbrëmje protestën kombëtare kundër qeverisë "Rama". Protesta është zhvilluar në një klimë të acaruar politike.

Partia Socialiste e drejtuar nga kryeministri Edi Rama, përveçse është e akuzuar për korrupsion, zhvilloi dhe votimet e 30 qershorit pa opozitën. Një vendim i tillë cilësohet si goditje përfundimtare e demokracisë dhe zyrtarizon kthimin e Shqipërisë në një

shtet ku një parti kontrollon çdo gjë.

Pak orë para nisjes së protestës, kreu i PD-së, Lulzim Basha, u ka bërë thirrje qytetarëve që të jenë në shesh. Përmes një videomesazhi të postuar në llogarinë e vet zyrtare në "Facebook", kryedemokrati bëri thirrje për pjesëmarrje masive në emër të "Shqipërisë së mundësive për të gjithë". "Arrogancës dhe shpërfilljes, iu përgjigjëm me refuzim padrejtësisë, do t'i përgjigjemi

me qëndresë! Pamundësinë, varfërinë, papunësinë nuk do t'ua lëmë trashëgim fëmijëve. Ne treguam se jemi më të fortë se e keqja. Ne duam një të ardhme me mundësi për të gjithë. Bashkë për të ardhmen! Bashkë për Shqipërinë!", janë mesazhet në videon e shpërndarë nga lideri i opozitës.

Basha ka ftuar qytetarët që të jenë në shesh me familjet. "Padrejtësinë, pamundësinë, varfërinë dhe papunësinë nuk do t'ua lëmë trashëgim fëmi-



jëve! Sonte në orën 20:00 në Tiranë të gjithë bashkë për familjen dhe fëmijët tuaj, për Shqipërinë e mundësive për të

gjithë! 8 korrik, Shqipëria si Evropa! Asnjë hap pas! Rama ik", ka shkruar Basha bashkëngjitur në postimin e tij.

Parlamenti voton komisionin hetimor për shkarkimin e presidentit Meta

Me kërkesën e socialistëve, Kuvendi i Shqipërisë ka votuar komisionin hetimor, duke i dhënë tre muaj afat për shkarkimin e presidentit Ilir Meta dhe objekt hetimi do të jenë të gjitha shkeljet e presidentit

TIRANË, 8 KORRIK - Kuvendi i Shqipërisë i jep tre muaj afat komisionit hetimor për shkarkimin e Ilir Metës. Pas votimit për ngritjen e komisionit dhe shtimin me dy anëtarë të tij nga 9 në 11, Kuvendi do ta votojë afatin tremujor për shkarkimin. Kjo do të thotë se brenda tre muajve ky komision duhet të dorëzojë raportin përfundimtar, që më pas do të përcillet për në Gjykatën Kushtetuese.

Sipas komisionit hetimor, objekt hetimi do të jenë të gjitha shkeljet e presidentit që, sipas shumicës, janë jo pak, por plot 9 të tilla. Por është i mjaftueshëm ky afat dhe mundet që deri atëherë të ngrihet Gjykata Kushtetuese dhe të ketë një vendim final.

Gjithsesi, për mazhorancën të gjitha janë të mundshme. "Në fakt, me të drejtë në 2017-n kanë dhënë një vendim të tillë, ku u referon konfliktet për dekretet për datat e zgjedhjeve Kolegjit Zgjedhor, apo Gjykatës Administrative, duke iu referuar nenit 131 apo 134 të Kushtetutës", thanë përfaqësues të mazhorancës.

Të pyetur se nëse Gjykata Kushtetuese do të ishte funk-

sionale, a do të ishte paditur akti i presidentit në këtë Gjykatë prej PS-së, deputetët thanë: "Një akt administrativ i pavlefshëm, për sa kohë nuk prodhon asnjë pasojë, nuk ka arsye përse të goditet. Si KQZ, KZAZ, ashtu edhe gjykatat e kanë konstatuar kryesisht pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ, sepse ka një praktikë të konsoliduar. Ne si subjekt do ta kishim ankimuar nëse ky akt do të kishte sjellë pasojë reale për t'i penguar zgjedhësit për votuar".

Rama e quan Metën armik të Kushtetueses dhe të Kuvendit

"Ilir Meta është armik i hapur i Kushtetutës dhe i Kuvendit, ndaj duhet ndëshkuar deri në fund", deklaroi të hënën kryeministri Edi Rama gjatë debatit në Kuvend për ngritjen e komisionit hetimor për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Ndërsa citoi shprehjen e Napoleon Bonapartit "kurrë mos e ndalo kundërshtarin që po gabon", Rama tha se "ne jemi të detyruar ta ndalojmë



Ilir Metën të gabojë më tej, sepse për ne dinjiteti i këtij shteti është më i rëndësishëm sesa çdo interes partiak". "Ilir Meta duhet hetuar e ndëshkuar deri në fund nga ky Kuvend dhe reagimi ynë ndaj tij duhet të jetë frontal dhe në emër të Kushtetutës, demokracisë parlamentare dhe pavarësisht çdo interesi politik që na ndan. Ilir Meta nuk është më thjesht kundërshtari i njohur i qeverisë, por është armiku i hapur i vet Kushtetutës së Shqipërisë; është armiku i deklaruar i vet

Kuvendit të Shqipërisë; nuk është më thjesht politikani i frikësuar deri në palcë nga reforma në drejtësi, por është shëmbëlltira e tërbimit të të tremburve nga drejtësia. Me shtrirjen e rrezes të agresionit të tij mbi miqtë dhe partnerët evropianë, ai na turpëron të gjithëve ne si deputetë, qytetarë, popullin dhe shtetin", tha Rama.

Shqipëria anëtare e NATO-s dhe kandidatë për në BE, sipas Ramës, nuk mund të ketë një kryetar shteti që duket si aktor komik që imi-

ton presidentin e Republikës dhe që kur flet seriozisht të bën për të qeshur, dhe kur flet me të qeshur, të bën për të qarë. "Një Vojo Kush me kravatë mbi çatinë e Ambasadës së ShBA-së, që e imagjinon si topin ku vendos gjoksin e tij si Mic Sokoli me rroba banje. Ai tha se është gati të përballlet me testin e shëndetit mendor çka, në fakt, nuk ia ka kërkuar askush, edhe pse gjithkush mund të pyesë veten se mos vallë është i ikur nga mendja e kokës", tha Rama.

Forcat e Armatosura të Shqipërisë ndërtuan një urë 42 metra të gjatë

TIRANË, 8 KORRIK (ER) - Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, Olta Xhaçka, ka bërë me dije,

përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", se Forcat e Armatosura të Shqipërisë ndërtuan në

Mbrezhdan të Këlcyrës një urë 42 metra të gjatë. Ministria Xhaçka ka theksuar se kjo urë lehtëson

lëvizjen e banorëve dhe mbështet nismën e qeverisë "100 fshatrat" në ndihmë të agroturizmit.



Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian vazhdojnë të kërkojnë heqjen e taksës

Taksa, pengesë për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) vazhdojnë të kërkojnë nga Qeveria e Kosovës heqjen e taksës për mallrat serbe. Zyrtarët e lartë amerikanë dhe evropianë kanë thënë se taksa vazhdon të mbetet pengesë për vazhdimin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ambasadori i ShBA-së në Beograd, Kyle Scott, ka thënë të hënën se pa e hequr taksën palët nuk mund të ulen në tavolinë për ta vazhduar procesin e dialogut

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimi Evropian (BE) vazhdojnë ta konsiderojnë taksën ndaj mallrave serbe si pengesë për vazhdimin e dialogut Kosovës - Serbi. Në çdo adresim publik, zyrtarët amerikanë dhe ata evropianë nuk hezitojnë të kërkojnë nga Qeveria e Kosovës heqjen e taksës dhe hapjen e rrugës për arritjen e marrëveshjes historike ndërmjet dy vendeve.

Së fundi, ambasadori i ShBA-së në Beograd, Kyle Scott, ka adresuar një kërkesë të tillë ndaj Prishtinës zyrtare. "Tarifa është një pengesë dhe ia kemi thënë qartë Qeverisë në Kosovë se ne mendojmë se ajo duhet të hiqet, kështu që ne mund të shkojmë në tavolinën e bisedimeve dhe atje është sfida më e madhe", ka thënë Scott.

Gjatë një aktiviteti në Beograd, diplomati amerikan ka thënë se BE-ja është udhëheqëse e këtij

dialogu. "E njëj ende udhëheqjen e Bashkimit Evropian në procesin e negociatave. Është e rëndësishme që të dyja palët të kthehen në tryezën e negociatave", ka thënë ai.

Gjithashtu, përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, ka ripërsëritur se nuk mund të thërrasë takim të radhës në mes të përfaqësuesve të dy shteteve pa heqjen e taksës. Ajo është shprehur optimiste se marrëveshja është e mundur dhe është afër. "Besoj se të dyja palët e kuptojnë se është në favor të njerëzve të tyre të arrijnë marrëveshje të plotë për normalizim të plotë (të marrëdhënieve), ligjërish të obligueshme, që mbulon të gjitha aspektet e vështirësive që janë ende në tryezë. Por, nëse më pyesni se a ka gjasa të arrihet në tre apo katër muajt e ardhshëm, unë ju them se derisa tarifa që u ka vënë Prishtina mallrave të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina mbetet në



fuqi, nuk shoh kushte për thirrjen e dialogut në nivel të lartë. Unë besoj se kjo është për keqardhje, sepse unë vërtet kam parë se elementet për marrëveshje për normalizim, ligjërish të obligueshme, ekzistojnë", ka thënë Mogherini për "Radion Evropa e Lirë".

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ia ka konfirmuar edhe një herë presidentit amerikan Donald Trump përkushtimin e Kosovës për dialog. Me rastin e përvjetorit të 243-t të Ditës së Pavarësisë së ShBA-së, Thaçi ia ka dërguar një letër homologut të tij amerikan në të cilën ka vlerësuar se në këtë proces lidhshipi dhe vizioni i Trumpit mbesin qenësorë për këtë synim. "Duke iu referuar letërës që ju më keni dërguar dhjetorin e kaluar, më lejoni të

konfirmoj se mbes i përkushtuar që të arrijmë një marrëveshje paqësore përfundimtare me Serbinë, që do të sjellë paqe të qëndrueshme dhe stabilitet në mes vendeve tona dhe tërë rajonit. Në fazën kritike në këtë proces, më lejoni të theksoj se lidhshipi dhe vizioni juaj mbesin qenësorë për këtë synim. Zoti i bekoftë Shtetet e Bashkuara të Amerikës!", ka shkruar Thaçi në letrën e tij. Por ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, mendon se dialogu ndërmjet dy vendeve nuk duhet të vazhdojë derisa të ndërrohet lidhshipi i BE-së. "Së pari ky dialog nuk duhet të vazhdojë derisa të ndryshojë lidhshipi i BE-së i cili është në ndryshim e sipër. Vetë znj. Mogherini si ndërmjetësuere e dialogut ka shkelur parimet evropiane të procesit,

duke lënë hapësirë që të bisedohet për ndryshimin e kufijve dhe dëmtimin e Kosovës. Pra, duhet të pritët shkuarja e Mogherinit dhe e atyre që ishin në vijën e lojërave të rrezikshme për ndryshim të kufijve, pastaj kur të konsolidohet lidhshipi i ri i BE-së, duhet të rinisë dialogu. Kjo i bie se mund të ndodhë në muajin tetor", ka thënë Tahiri, duke shtuar se deri në atë kohë Kosova duhet të ndërtojë një ekip uniteti për dialog i cili duhet ta përfaqësojë edhe spektrin opozitar.

Liderët institucionalë të Kosovës kanë mbrojtur qëndrimin se dialogu ndërmjet dy vendeve nuk duhet të kushtëzohet nga Serbia me heqjen e taksës. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se taksa nuk do të hiqet derisa Serbia nuk e njeh Kosovën.

Duda Balje: Kosova, lidere në respektimin e të drejtave të njeriut

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, kanë pritur të hënën në takim homologët nga Kuvendi i Maqedonisë Veriore për të diskutuar për çështjet aktuale të të drejtave të njeriut, të barazisë gjinore, të drejtat e bashkësive nacionale, si dhe për këmbimin e praktikave më të mira nga fushat e lartpërmendura.

Kryetarja e këtij komisioni, Duda Balje dhe zëvendëskryetarja Lirije Kajtazi kanë shprehur mirënjohje për bashkëpunimin e arritur në mes të këtyre dy komisioneve, duke sugjeruar që ky bashkëpunim i mirëfillt të vazhdojë edhe më tutje.

Gjatë këtij takimi anëtarët e komisionit kanë shpalosur të arriturat e Komisionit për të



Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, duke iu dhënë theks të veçantë punimeve të fundit lidhur me të drejtat e njeriut dhe peticioneve që marrin nga qytetarët.

Lidhur me këtë çështje para delegacionit të Maqedonisë Veriore ata kanë parashtruar disa pyetje që fokus kishin shërbimet që ofrohen për personat që përjetojnë dhunë në familje dhe trajtimin e peticioneve që vijnë drejtpërdrejt nga qytetarët. Ata kanë theksuar se marrin model nga praktikat e mira që Kosova aplikon lidhur me të drejtat e njeriut dhe kanë treguar se kanë gjetur zgjidhje pozitive, duke miratuar ligje për personat që përjetojnë dhunë në familje dhe

ligje për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Për praktikat që Kosova është duke ndjekur në këtë fushë, kryetarja e komisionit, Duda Balje, ka thënë se Republika e Kosovës është lidere në respektimin e të drejtave të njeriut.

Flet për "Epokën e re", Haki Rugova

Kjo qeveri s'mund të shkojë më



Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Haki Rugova, ka bërë me dije se kjo parti po insiston për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për shkak të keqqeverisjes që po i ndodh vendit. Ai ka thënë se asnjë segment i qeverisjes nuk është duke punuar si duhet dhe, sipas Rugovës, ky koalicion nuk mund t'i zgjidhë problemet madhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se kjo qeveri nuk mund të shkojë më larg se në fillim të vjeshtës. Rugova ka shprehur optimizëm se LDK-ja do t'i fitojë zgjedhjet dhe do ta qeverisë vendin në mandatin e ardhshëm. Ai ka folur edhe për zgjedhjet brenda LDK-së duke thënë se rrahjet që e kanë përcjellë këtë proces nuk mund të kenë efekt negativ në elektorat. Rugova nuk e ka mohuar mundësinë që t'i hyjë garës për kryetar të LDK-së, por ka thënë se duhet të arrihet një marrëveshje paraprake

dukur për rrëzimin e qeverisë. Kjo qeveri nuk mund të shkojë më tutje sesa në fillim të vjeshtës.

"Epoka e re": Pse mendoni se qeverisja e LDK-së mund ta ndryshojë gjendjen në vend?

Rugova: Për arsye se populli e ka provuar qeverisjen e LDK-së dhe unë mendoj se nuk ka pasur qeverisje më të mirë që nga paslufta e këndeje se në kohën kur këtë qeveri e ka udhëhequr Isa Mustafa. Ka dëshmi të mjaftueshme që e vërtetojnë këtë që po them, në radhë të parë nuk ka pasur asnjë afër korruptive gjatë asaj periudhe.

"Epoka e re": Nëse veç do të mbahen zgjedhjet e parakohshme, jeni optimistë se LDK-ja do të mund të dalë e para dhe ta formojë qeverinë?

Rugova: Shpresoj dhe jam i bindur se LDK-ja do të dalë e para, por nuk mund të qeverisë e vetme, sepse rrethanat janë të tilla. Asnjë parti e vetme nuk mund t'i fitojë mbi 50 për qind të votave në mënyrë që të qeverisë e vetme.

"Epoka e re": Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë së fundmi se Kosova si kurrë më parë ka nevojë të udhëhiqet nga partitë që aktualisht janë në opozitë. Do të

mund të funksiononte një qeveri në mes të LDK-së dhe LV-së apo anasjelltas?

Rugova: Koalicionet janë gjithmonë të mundshme në mes të partive opozitare, sepse opozita po kërkon shkuarjen në zgjedhje të parakohshme. Prandaj, është shumë normale që të shkohet në këtë formë. Mirëpo kjo do të jetë çështje e marrëveshjeve qoftë para zgjedhjeve apo qoftë pas zgjedhjeve.

"Epoka e re": Por duke u bazuar nga e kaluara, pavarësisht prej deklaramëve të tilla, pas zgjedhjeve LDK-ja dhe PDK-ja kanë përfunduar bashkë në qeverisje.

Rugova: Përvojat asnjëherë nuk janë të njëjta dhe nuk mund të kopjojmë nga përvojat e kaluara. Çdo kohë sjell situata të reja. Nuk dua të flas se çfarë ka ndodhur në të kaluarën, por as të spekuloj se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Mirëpo ne do të shkojmë me parimet çfarë i ka LDK-ja dhe ashtu do të qëndrojmë.

"Epoka e re": Problemet dhe rrahjet që e kanë përcjellë procesin zgjedhor brenda LDK-së, a mund të kenë efekt negativ në elektorat në rast se do të ketë zgjedhje këtë vit?

Rugova: Ato kanë qenë disa incidente që kanë ndodhur në

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Rugova, si po i shihni zhvillimet e fundit në skenën politike dhe pse LDK-ja po insiston që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme? I ka opozita votat për rrëzimin e qeverisë?

Rugova: Po insistojmë në zgjedhje të parakohshme për shkak të keqqeverisjes që po i ndodh vendit. Për asgjë tjetër. Nuk është çështje inatësh këtu, por në të vërtetë asnjë segment i qeverisjes nuk është duke

punuar si duhet. Prandaj, kërkojmë dhe besojmë shumë se është e pamundshme të funksionojë normalisht shteti me qeverisjen aktuale.

"Epoka e re": Koalicioni qeverisës ka kapacitete t'i finalizojë me sukses proceset me të cilat po ballafaqohet vendi?

Rugova: Nuk besoj se ky koalicion mund t'i zgjidhë problemet madhore. Pavarësisht prej premtimeve, nuk ka liberalizim të vizave, dialogu ka ngecur dhe nuk ka zhvillime pozitive në politikën e jashtme në përgjithësi. Kemi probleme edhe në aspektin

e qeverisjes së brendshme, ka keqmenaxhim të parasë publike, papunësia është shumë e madhe dhe më e dhimbshme është largimi i të rinjve nga Kosova. Ka shumë arsye që LDK-ja insiston dhe kërkon domosdo zgjedhje. Pra, porsa të arrijmë t'i bëjmë votat, menjëherë do ta ngrehim mocionin i cili ka për qëllim rrëzimin e qeverisë. Në fund të fundit, kjo është detyra e opozitës.

"Epoka e re": Kur do të mund t'i siguroni 61 vota?

Rugova: T'ju them të drejtën sa më shpejt që të ndodhë aq më mirë do të jetë. Është koha e

I larg se në fillim të vjeshtës

duhet të presim se cilët janë kandidatët potencialë dhe si do të zhvillohet procesi.

"Epoka e re": Ju, a do ta futeni në garën për të parin e LDK-së në Kuvendin Qendror?

Rugova: Përderisa flas këtu për të tjerët, cila është arsyeja që të mos flas për veten. Por nuk e kam shfaqur asnjë pretendim, kështu që nuk kam nevojë t'ju përgjigjem në këtë pyetje.

"Epoka e re": Por ne dhe publiku ka interesim të dijë nëse do t'i hyni apo jo garës për kryetar të LDK-së?

Rugova: Nuk dua t'i prij një procesi i cili mund të shkaktojë opinione dhe dëme. Anëtarësia

jonë i ka bindjet e veta dhe është e drejtë që të llobohet për secilin kandidat.

"Epoka e re": Ju nuk dëshironi ta prishni procesin, prandaj nuk do t'i hyni garës?

Rugova: Jo, nuk mund të thuhet ashtu. Nuk po dua të them se kandidatura ime mund ta prish procesin në asnjë mënyrë, përkundrazi ajo mund edhe ta begatojë. Por kjo nuk është temë me të cilën unë jam duke u marrë. Derisa të përfundojë procesi zgjedhor nëpër të gjitha degët, të konstituohet një kuvend, t'i shohim listat e kuvendeve dhe atëherë do të shihet se si do të procedohet tutje. Unë jam i bindur se

kryesia e LDK-së do të shkojë me marrëveshje të duhura. Pse mos të ketë marrëveshje? Marrëveshjet i zgjidhin edhe shumë probleme të tjera.

"Epoka e re": Ju jeni ithtar që për zgjedhjen e kryetarit të LDK-së të ketë një marrëveshje paraprake e cila i shmang problemet?

Rugova: Pse mos të ketë? Rregullat e lojës mund të jenë edhe të tjera por, në fund të fundit, do të shkohet me votë në kuvend dhe nuk ka asnjë problem. Le t'i paraqesin njerëzit kandidaturat e veta dhe kështu funksionon LDK-ja dhe do të funksionojë edhe më tutje pa asnjë problem.

AAK-ja fton organet e drejtësisë të merren me keqpërdorimet e Komunës së Pejës

PEJË, 8 KORRIK (ER) - Kryetari i Degës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Pejë, Ali Berisha, të hënën në një konferencë për medie ka shprehur shqetësimet e kësaj partie rreth keqpërdorimeve në Komunën e Pejës e cila drejtohet nga Gazmend Muhaxheri nga radhët e LDK-së. Duke numëruar konstatimet në Raportin e Zyrës së Kombëtare të Auditimit (ZKA), Berisha ka kërkuar nga prokuroria dhe policia që të merren urgjentisht me keqpërdorimet në Komunën e Pejës. "Ndër 16 të gjeturat e auditorit ka edhe shumë vërejtje të tjera të kësaj natyre, por edhe të tjera si: pasojat e pagesave përmes vendimeve gjyqësore-përmbarrimore, parregullsi në menaxhimin e tatimit në pronë, raportim i pjesshëm dhe vonesa në pagesën e faturave të

papaguara e shumë vërejtje të tjera, por për ta përmbyllur përshkrimin e këtij raporti do ta përdorim konkluzionin e vet auditorit. Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen është se ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Pejës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial", ka thënë Berisha. Sipas tij, vetëm sjellja para ligjit e pushtetarëve mund t'i ndalë fenomenet tashmë të dëshmuara të atyre që dëmtojnë paranë e qytetarëve të Komunës së Pejës. Më tutje, ai ka tërhequr vërejtjen edhe në disa pika me rëndësi të vëna në pah nga ZKA-ja. "Montimi i kaldajës për ngrohje në kuadër të mirëmbajtjes së shkollave në vlerë prej 900 eurosh ishte faturuar dhe

paguar dy herë. Tri pozicione në projektin për ndërtimin e Shkollës së Muzikës 'Halit Kasapoli' ishin më të larta se çmimet e kontraktuara, si rezultat janë paguar rreth 1 065 euro më shumë se që është dashur. Te projekti: Ndërtimi i Shkollës së Mesme të Artit 'Odhise Paskali', auditori ka verifikuar në vend të ngjarjes se furnizimi me shkalët metalike të kombinuara me dru nuk janë punuar, por janë paguar pa u punuar. Raporti ka konstatuar se në tri kontrata ka pasur ndryshime të sasive brenda kontratës pa aprovim si parashihet me ligj. Raporti, gjithashtu, ka potencuar se 22 projekte të asfaltimit janë zbatuar pa projekt ekzekutim. Ky fenomen po sjell deri te zbatimi i çuditshëm i traseve të rrugëve dhe te cilësia e dobët e punimeve", është shprehur Berisha.

disa degë apo edhe nëndegë, mirëpo unë nuk besoj se mund ta prishin imazhin e LDK-së në zgjedhje. Procesi zgjedhor brenda LDK-së deri më tani ka shkuar jashtëzakonisht mirë dhe shpresoj se do të përmbillet mirë. LDK-ja është në gjendje që t'i sanojë të gjitha këto defekte të vogla që janë paraqitur gjatë procesit dhe do të përfundojë çdo gjë mirë dhe për këtë jam shumë i sigurt. LDK-ja e ka përvojën dhe aftësinë që t'i menaxhojë këto si duhet deri në fund.

"Epoka e re": Ju keni arritur të rizgjedheni kryetar i Degës së LDK-së në Istog, por ka pasur akuza ndaj juve dhe të tjerëve që janë rizgjedhur në krye të degëve, madje ju kanë kritikuar se nuk po ua lëshoni vendin të tjerëve.

Rugova: Nuk ka ndonjë kryetar komune apo kryetar dege që nuk mund të kritikohet dhe nuk është kritikuar, prandaj nuk do të veçoja asnjë. Çdo udhëheqje apo proces ka defektet e veta, por dega dhe anëtarësia e LDK-së në mënyrë unanime kanë vendosur që unë ta udhëheq edhe për një mandat Degën e LDK-së në Istog.

"Epoka e re": Me gjithë këto probleme dhe pengesa në tërësi,

si e vlerësoni finalizimin e këtij procesi zgjedhor?

Rugova: Ka qenë një proces i mirë zgjedhor dhe jam i bindur se do të rezultojë mirë dhe vlerësimin final do ta japim në përfundim të procesit zgjedhor që do të kulmojë me organizimin e një kuvendi qendror.

"Epoka e re": A ka rrezik që edhe Kuvendi Zgjedhor të përcillet me rrahje dhe të ketë një ndarje tjetër të partisë?

Rugova: Jo, nuk besoj se do të ndodhë një gjë e tillë, sepse LDK-ja ka përvoja të këqija në atë drejtim. Prandaj, nuk do të lejojmë që dikush të realizojë skenarë të tillë. Pra, LDK-ja do ta menaxhojë mirë këtë situatë dhe nuk do të ketë asnjë problem në kuvendin qendror.

"Epoka e re": Z. Rugova, deri më tani zyrtarisht nuk ka kandidat për kryetar të LDK-së, por që mundësinë për këtë nuk e ka përjashtuar as Isa Mustafa, Fatmir Sejdiu, Lutfi Haziri etj. Sipas mendimit tuaj, kush duhet ta drejtojë LDK-në në mandatin e ardhshëm?

Rugova: Është krejt normale dhe të gjithë ata janë kandidatë të mundshëm, por kandidaturat për kryetar të LDK-së do të shfaqen në Kuvend. Prandaj



Ndahen çmimet në fushën e artit pamor

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 KORRIK - Të hënën në një ceremoni solemne të organizuar në kabinetin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, është bërë ndarja e çmimeve në fushën e artit pamor.

Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi", që u shoqërua me një certifikatë të nënshkruar nga ministri, pllakate dhe një shpërblim në vlerën monetare prej 5 000 eurove, iu nda prof. Agim Çavdarbashës - "postmortem", ndërsa Çmimi Vjetor për të Arriturat në Fushën e Artit Pamor, që gjithashtu u shoqërua me një certifikatë të nënshkruar nga ministri Gashi dhe një shpërblim në vlerën monetare prej 3 000 eurove, iu nda profesorit Agim Salihu.

Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se është një ditë e veçantë për krijuesit tanë të kësaj fushe po edhe për Ministrinë e Kulturës që të jetë pranë edhe në kuptimin e mirënjohjes dhe falënderimit përmes dhënies së çmimeve. "Ishte jashtëzakonisht çast i mirë që juria ka vendosur për dhënien e këtyre çmimeve e veçanërisht që Çmimi për Veprimtari Jetësore 'Muslim Mulliqi' t'i jepet një figure shumë të madhe të vendit tonë siç ka qenë profesor Agim

Qavdarbasha dhe i jam shumë mirënjohës jurisë që ka vendosur drejt dhe në mënyrën më profesionale për këtë figurë të çmuar. Po ashtu, e uroj dhe e përgëzoj edhe profesorin Agim Salihu për Çmimin Vjetor për të Arriturat në Fushën e Artit Pamor", u shpreh ministri Gashi.

Për vendimin e jurisë për t'i vlerësuar këto dy figura, ministri tha: "Ne vetëm kemi qenë mbështetës dhe kemi shprehur mundësinë që të vendosin profesionistët. Gjithashtu, jam këtu për ta konfirmuar mbështetjen e Ministrisë për të gjithë artistët dhe krijuesit dhe jo vetëm përmes ndarjes së çmimeve, por edhe përmes mbështetjes së projekteve të artit e të kulturës", ka pohuar ministri Gashi.

Çmimin Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi" e mori bashkëshortja e të ndjerit Agim Çavdarbasha e cila në fjalën e saj falënderoi ministrin Gashi dhe jurinë për vlerësimin e bërë. "Si përfaqësuese e fondacionit Agim Çavdarbasha dhe si bashkëshorte e Agimit e, po ashtu, bashkë me djemtë dhe familjen jemi të lumtur që e kemi bërë vlerësimin më të lartë. Mendoj se deri tash e kemi prituri dhe mendoj se ai nuk është një artist vetëm i Kosovës, por edhe mbarëkombëtar. Besoj edhe shpresoj se ne do ta vazhdojmë bashkëpunimin dhe që



në të ardhmen ato skulptura që gjenden në muze do të ruhen dhe do ta kenë kujdesin e të gjithë njerëzve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore", ka thënë ajo.

Falënderues ndaj ministrit dhe jurisë u shpreh edhe fituesi i Çmimit Vjetor për të Arriturat në Fushën e Artit Pamor, Agim Salihu. "Ky çmim për mua ka rëndësi të madhe se shteti po nderon artistin dhe kur shteti e nderon artistin atëherë ka një

peshë më të madhe dhe artisti ka një presion më të madh për sakrificat që ka bërë edhe për mundin", ka thënë Salihu.


Sipas jurisë vlerësuese në përbërje të Mehmet Behlulit, Mirsad Lushtakut dhe Besnik Xhemailit, prof. Agim Çavdarbashës i ndahet postmortem Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Muslim Mulliqi" pasi që me aktivitetin e tij, përveç që ka kontribuar në cilësinë e artit pamor, ka

prezantuar Kosovën edhe në "Dokumente 14", që njëherësh është edhe një prej aktiviteteve më me peshë në skenën e artit botëror.

Ndërsa prof. Agim Salihut i ndahet Çmimi Vjetor për të arriturat në fushën e artit pamor pasi që me aktivitetet e tij ka lënë gjurmë në artin pamor, ka prezantuar Kosovën edhe në disa aktivitete-bienale shumë të rëndësishme si në Kinë dhe Japoni.

MD-ja: Vetëvendosja po ndërhyr për ta mbrojtur monopolin në fushën e noterisë

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Ministria e Drejtësisë e konsideron të papranueshme ndërhyrjen e qëllimshme politike të Lëvizjes Vetëvendosje në procesin profesional dhe konform standardeve ligjore të provimit të noterisë, duke e cilësuar këtë ndërhyrje si një përpjekje të hapur për të sabotuar një ndër reformat më të rëndësishme që mundësojnë qasje më efikase, më të shpejtë dhe sa më afër qytetarëve në shërbimet noteriale. "Si një proces i realizuar ekskluzivisht mbi Ligjin për Noterinë dhe aktet e tjera përcjellëse, organizimi i provimit të noterisë dhe vlerësimet e komisionit profesional janë çështje ekskluzivisht profesionale dhe jopolitike. Shtimi i numrit të noterëve është në qendër të reformave të



drejtësisë për shkak se shërbimet noteriale aktualisht mungojnë në një pjesë të konsiderueshme të komunave të Republikës së Kosovës dhe qytetarët e vendit kanë nevojë për qasje të drejtpërdrejtë në këto shërbime sa më afër vend-

banimit të tyre dhe me shpenzime sa më të vogla financiare", është thënë në reagimin e Ministrisë së Drejtësisë. Sipas kësaj ministrie, një ndërhyrje e tillë e Lëvizjes Vetëvendosje në këtë proces profesional është në dobi

ekskluzive të grupeve të interesit që për shkak të rrethanave të mungesës së numrit të mjaftueshëm të noterëve, kanë zhvilluar një praktikë të plotë të monopolit në shërbimet noteriale.

"Rrjedhimisht, Vetëvendosja, duke u përpjekur ta nxisë sabotimin e këtij procesi profesional, në fakt po merr në mbrojtje me qëllim aktorë të caktuar që kanë përfutur miliona euro nga monopolet e tyre në fushën e noterisë", është thënë në këtë reagim.

Ministria e Drejtësisë ka siguruar qytetarët se është e vendosur për ta realizuar në plotësi reformën që synon rritjen e numrit të noterëve në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës dhe në të gjitha komunitetet e saj pa dallim. "Pas përfundimit të këtij procesi profesional të provimit

të noterisë do të fillojë faza e rekrutimit të tyre në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe në monitorim të ngushtë nga partnerët tanë zhvillimorë. Me rekrutimin e noterëve të rinj, qytetarët e Republikës së Kosovës në të gjithë territorin e saj, shërbimet noteriale do të kenë mundësi t'i marrin me një qasje më të shpejtë dhe sa më afër vendbanimeve të tyre. Ministria e Drejtësisë e fton Lëvizjen Vetëvendosje që t'i japë fund kësaj tentative sepse shembja e monopoleve është kërkesë e qytetarëve, kërkesë e partnerëve tanë zhvillimorë dhe është në funksion të plotë të qasjes më të lehtë e më efikase në drejtësi", është theksuar në reagimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Jahjaga: Përgjithmonë i jemi mirënjohës diasporës

CYRRIH, 8 KORRIK (ER) - Me iniciativën e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Cyrih, ish-presidentja Atifete Jahjaga është takuar me gra nga Kosova që vijnë nga fushat e ndërmarrësisë, poli-

tikës, shkencës dhe artit, të cilat kanë korrur sukses në Zvicër, por në të njëjtën kohë kanë dhënë kontributin e tyre në Kosovë. "Diaspora jonë në mënyra të ndryshme kontribuon në Kosovë duke

filluar nga ekonomia e deri te ruajtja e vlerave kulturore dhe historike të popullit tonë. U jemi mirënjohës përgjithmonë", ka shkruar Jahjaga në llogarinë e vet në "Facebook".



Hapet edicioni i 19 i Universitetit Veror të Prishtinës

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë të hënën në hapjen e edicionit të 19 të Universitetit Veror Prishtinës. Me hapjen e këtij edicioni, mes Ministrisë dhe Universitetit "Hasan Prishtina" u nënshkrua edhe një memorandum bashkëpunimi me qëllim të mbështetjes së universitetit në organizimin e Universitetit Veror Ndërkombëtar. Ministri Gashi në emër të Qeverisë së Kosovës përshëndeti tubimin e hapjes së Universitetit Veror të Prishtinës. "Edhe me këtë edicion ndërkombëtar dhe me programin e tij shumë të avancuar akademik, Universiteti i Prishtinës po e vazhdon traditën e hapjes ndaj arritjeve dhe vizioneve më bashkëko-

hore të dijeve akademike, universitare në nivel ndërkombëtar", u shpreh ministri Gashi. Ai tha se përmes Universitetit Veror Ndërkombëtar jo vetëm Universiteti i Prishtinës, por Kosova mbarë është e vendosur që urat e bashkëpunimit universitar, akademik, shkencor ndërkombëtar, në fushën e kërkimeve, në vazhdimësi, t'i zgjerojmë me përmajtje të reja. "Njerëzit e ditur, me dije universitare siç dëshmon edhe Universiteti Veror i Prishtinës, janë lajmëtarët dhe farkëtarët e kësaj bote të re, e botës prospective. Mbi këtë filozofi të ideve dhe të dijes universitare, institucionet e Qeverisë së Kosovës janë të vendosura që edhe përmes integritit të dijeve shkencore në nivel ndërkombëtar të korrespondojmë me arritjet më bashkëkohore të dijes universale", ka thënë Gashi.

Ministri ka theksuar se institu-

cionet e Republikës së Kosovës i kushtojnë vëmendje të veçantë procesit të arsimit dhe edukimit për të krijuar breza elitare. "Miq të tanë ndërkombëtarë, profesorë dhe studentë nga universitetet botërore, do të kenë mundësi që edhe përmes edicionit të 19-të të Universitetit Veror dhe mikpritjes në Kosovë të njihen me arritjet jo vetëm universitare, por edhe ato sociale, ekonomike dhe kulturore të Kosovës", ka thënë Gashi. Ndërkaq për sa i përket nënshkrimit të memorandumit, ministri ka theksuar se, pavarësisht se si ministri nuk e mbulojnë pjesën e menaxhimit të fushës së arsimit, në rrafshin e bashkëpunimit kulturor dhe rinor kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë gjithmonë të gatshëm. "Në këtë aspekt po përipiqemi të jemi të pranishëm çdo kund me aktivitetet tona", është shprehur ai.

Duke uruar që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen, ministri Gashi ka folur edhe për çështjen e Fakultetit të Arteve dhe ka bërë me dije synimet për ndërtimin e objektit të teatrit, operës dhe baletit. Ai ka sqaruar se do të jetë një kompleks i Fakultetit të Arteve dhe sallës së teatrit, operës dhe baletit, për të cilin nuk do të mungojë përkrahja e Ministrisë. Ndërsa rektori Marjan Dema u shpreh i kënaqur me nënshkrimin e memorandumit dhe ka falënderuar ministrin për përkrahjen e dhënë, duke thënë se pret që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe më tutje.



Bëhet gati shtatorja e Hamëz Jasharit

SKENDERAJ, 8 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, dhe nënkryetari Nuredin Lushtaku kanë vizituar të hënën atelienë e skulptorëve Ylber Krasniqi dhe Sabri Behrami të cilët janë duke e punuar shtatoren e heroit të Kosovës, Hamëz Jashari, vëllait të komandantit legjendar Adem Jashari. Me këtë rast, Bekim Jashari, i cili është djali i Hamzës, ka lavdëruar punën e dy skulptorëve. "Sot isha bashkë me nënkryetarin dhe

shokun e bashkëluftëtarin e Adem dhe Hamëz Jasharit për ta parë punën e skulptorëve tanë, Ylberit dhe Sabriut. Ju lumshin duart të dyve për një vepër kaq të përkryer! Shumë faleminderit! Gjithmonë krenar që jam gjaku yt dhe me veprën tënde!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Shtatorja e Hamëz Jasharit do të vendoset në Drenas së bashku me shtatoren e Shaban dhe Adem Jasharit.



Lekaj për mashtrimet me patentshoferë: Po presim vendimin e gjykatës

Prishtinë, 8 korrik - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka folur në lidhje me rastin e fundit të arrestimeve të zyrtarëve të kësaj ministrie për keqpërdorimet me patentshoferë. Lekaj ka thënë se për këtë çështje janë duke pritur vendimin e Gjykatës Themelore. "Sa i përket rastit të patentshoferëve apo zyrtarëve që janë arrestuar nga policia, mendoj se nga fillimi i marjes se mandatit i kam vënë në dijeni të gjithë ata që tentojnë ta keqpërdorin detyrën zyrtare që drejtësia do të ketë vend për ta. Dhe unë asnjëherë në asnjë mënyrë nuk kam qenë pengues i proceseve dhe ftoj prokurorinë dhe gjyqësinë të jenë korrekte dhe t'i shkojnë

çështjes deri në fund", ka thënë Lekaj për "Ekonomia Online". Lekaj ka thënë se pas vendimit të gjykatës do të vendosin në përputhje të ligjeve në fuqi. "Ne po presim vendimin e gjykatës. Pas vendimit të gjykatës do të marrim vendime sipas Ligjit për shërbyesit civilë dhe Kodit Penal dhe është në detyrën e sekretarit që të marrë vendime", ka thënë Lekaj. Më 5 korrik Policia e Kosovës ka arrestuar 23 persona si të dyshuar se kanë kryer veprën penale të korrupsionit duke dhënë patentshoferë në këmbim të parave. Në këtë aksion janë arrestuar zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës, mjekë, pronarë të autoshkollave etj.



Oda e Avokatëve diskutoi për mangësitë që ka Projektligji i Punës

PRISHTINË, 8 KORRIK - Oda e Avokatëve ka diskutuar të hënën rreth Projektligjit të Punës, duke vënë në pah mangësitë dhe përparësitë e këtij projektligji.

Shpalosja e të gjeturave rreth këtij projektligji është bërë pas një punëtorie ku komiteti i

Odës së Avokatëve ka mbajtur një takim për këtë projektligj. Në këtë takim është thënë se në Projektligjin e Punës nuk është marrë shumë parasysh interesi i të papunëve dhe se ligji duhet të jetë i tillë që ta zbusë normën e papunësisë.

Avokati Florin Lata, duke folur

rreth shkallës së papunësisë në Kosovë, ka thënë se Projektligji i Punës mund të ndikojë në uljen e papunësisë dhe rritjen e saj. Sipas tij, me Projektligjin e Punës mund të parashihen barrierat të cilat i pengojnë punëdhënësit të punësojnë punëtorë të rinj. Ai ka thënë se

Projektligji i Punës duhet të jetë katalizator i zhvillimit ekonomik. Lata ka deklaruar se do t'i japin konkluzionet e tyre në lidhje me Projektligjin e Punës.

Ndërsa kryetarja e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, deputetja Besa Baftiu, ka thënë

se me gjithë mangësitë që ka pasur, i kanë dhënë mundësi projektligjit të diskutohet në seancë plenare. Ajo ka bërë me dije se si komision kanë kërkuar një hulumtim nga Zyra Ligjore pranë Kuvendit të Kosovës prej ku kanë marrë shumë vërejtje.



Matoshi thotë se nuk ka fuqi ta ndalojë ndërtimin e hidrocentraleve në Shtërpcë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka raportuar të hënën para Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ku të pranishëm kanë qenë edhe disa banorëve të fshatit Biti e Poshtme e Komunës së Shtërpcës.

Ministri Matoshi gjatë raportimit të tij ka kërkuar që edhe deputetët e Kuvendit të Republikës të ndërmarrin hapa konkretë për çështjet e hidrocentraleve dhe operimin e tyre në Kosovë. "Jemi në një fazë që unë në mënyrë arbitrare nuk mund t'i ndërpres

punimet sepse investitorët që janë duke punuar atje kanë dokumente të rregullta. Përveç Kuvendit që mund ta ndërpresë këtë çështje përmes akteve ligjore, unë nuk e kam fuqinë si ministër ta ndërpres", ka thënë ministri Matoshi.

Ai ka thënë se janë deputetët e Kuvendit të Kosovës që kanë miratuar ligje për hidrocentrale dhe se MMPH-ja është vetëm për zbatim të këtyre ligjeve. "Merreni një iniciativë në Kuvend për ta ndryshuar ligjin, futeni në fuqi një moratorium deri në nxjerrjen e ligjit të ri, njëjtë siç keni bërë për kazinotë dhe ne e zbatojmë prej ditës së parë. Lejet mjedisore, lejet ujore, pikërisht ju i keni miratuar, deputetët i kanë



votuar dhe ne tashmë i zbatojmë", ka thënë Matoshi.

I pari i MMPH-së ka treguar për iniciativën e ndërmarrë ku ka njoftuar ZRrE-në për hidrocentralet që nuk plotësojnë kriteret ligjore për operim dhe

si pasojë e kësaj janë shkyçur tri hidrocentrale prej shitjes së energjisë.

Matoshi iu përgjigj deputetëve dhe banorëve të fshatit Biti e Poshtme të cilët pohuan se në ndërtimin e hidrocentraleve

nuk ka pasur debat publik duke thënë se "ne do të sigurohemi që t'i marrim procesverbalet në vitin 2013-2014 dhe listën e pjesëmarrësve në këto debate publike".

Ministri Matoshi gjatë këtij raportimi është shprehur i hapur që t'i paraqesë të gjitha dokumentet që MMPH-ja i ka dhënë për hidrocentrale në Kosovë. Ai ka mirëpritur edhe iniciativën e Komisionit për krijimin e një komisioni hetimor për hetimin e operimit të hidrocentraleve në Kosovë.

Nga kjo mbledhje e komisionit parlamentar, Matoshi dhe deputetët u morën vesh që MMPH-ja të dërgojë një skicë mbi përgjegjësitë e secilit institucion që lidhet me hidrocentrale.

KEDS-i vendos katër trafo të reja në Smërkovnicë të Vushtrrisë

VUSHTRRI, 8 KORRIK (ER) - Në fshatin Smërkovnicë të Vushtrrisë KEDS-i ka ndërtuar katër trafo të reja, dy trafo që kanë qenë të vjetra janë zëvendësuar me të reja dhe dy trafo janë ndërtuar krejtësisht të reja dhe është instaluar rreth 1000 metra kabllo të izoluar (bistekë), ku është përmirësuar tensioni dhe është hequr rreziku për

banorët. Me këtë investim banorët tashmë kanë zgjidhur problemin e tyre energjetik për disa dekada të ardhshme.

Investimi i KEDS-it, duke rritur edhe kapacitetet energjetike, do t'u mundësojë rreth 300 familje që banojnë këtu të kenë një të ardhme më të mirë. Në

këtë investim është përfshirë komplet fshati. Aty janë ndërtuar të gjitha shtyllat që kanë qenë me përçues të zhveshur dhe me rrezik për banorët dhe tani janë vendosur shtylla të reja me kabllo të izoluar (bistekë), ku është përmirësuar tensioni dhe është hequr rreziku për

banorët.

KEDS-i është duke vazhduar projektin e investimeve nëpër të gjithë territorin e Kosovës. Investimet e KEDS-it kanë nisur qysh në vitin 2013 dhe deri më tani kanë përfituar shërbime kualitative më të mira konsumatorë anembanë vendit.



OEK-u dhe UNDCO-s synojnë t'i rrisin aftësitë për punësim



Oda Ekonomike e Kosovës dhe Zyra e Koordinatorës për Zhvillim të OKB-së (UNDCO) arrijnë memorandum bashkëpunimi përmes të cilit synohet zbatimi i nismave që rrisin aftësitë për punësim të fuqisë punëtore në Kosovë, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë, rrisin produktivitetin e bizneseve të gjelbra dhe kontribuojnë në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm brenda agjendës 2030

bizneseve të gjelbra dhe kontribuojnë në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm brenda agjendës 2030.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij bashkëpunimi është që UNDCO ta mbështesë rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse në Kosovë, mbështetjen e ndërmarrësisë së grave në nivel lokal dhe promovimin e iniciativave të gjelbra lidhur me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm që dalin nga rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25 janar 2018.

Në hapjen e kësaj ceremonie kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se kjo marrëveshje konkretizohet pas një komunikimi të vazhdueshëm dypalësh mes dy institucioneve dhe rrjedhimisht sot po finalizojnë bazat e bashkëpunimit mes sektorit privat të përfaqësuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara.

Rukiqi ka thënë se praktikatat nga vendet e ndryshme kërkojnë

përfshirjen e sektorit privat, sidomos për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, që shkojnë në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, jo vetëm të sektorit privat.

Ndërsa Ulrika Richardson, koordinatore për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ka theksuar se konkretizimi i kësaj marrëveshje vjen si rezultat i përkushtimit të OKB-së në nivel global që ta angazhojë sektorin privat si bashkëpunëtor të ngushtë për arritjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm në kuadër të agjendës 2030.

Kosova ka dhënë përkushtim për implementim të kësaj agjende përmes rezolutës së miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe themelimit të Këshillit Parlamentar për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. "Arritja e këtyre objektivave nuk është përgjegjësi vetëm e qeverisë, por është e të gjithë shoqërisë, prandaj po

bëjmë këtë bashkëpunim me OEK-un në mënyrë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm gjithëpërfshirës për të gjitha komunitetet në Kosovë", ka thënë Richardson.

Marrëveshja e arritur mes OEK-ut dhe Zyrës së Koordinatorës për Zhvillim të OKB-së (UNDCO) ka dy qëllime kryesore: 1. Përsheptimin e zhvillimit dhe konkurrencën e sektorit privat në Kosovë dhe të promovohet një zhvillim ambiantal i qëndrueshëm. Pastaj, rritja e vetëdijes për aspektet ambiantaliste, rritja e aftësive të sektorit privat në Kosovë për këtë aspekt. 2. Barazia gjinore në sektorin privat, luftimi i korrupsionit si sinjal për zhvillim të qëndrueshëm, është i patjetërsueshëm edhe në Kosovë. Pastaj "rritja e gjelbër" (greengrowth) e kompanive, por me theks të veçantë grave në ndërmarrësi që janë, njëherësh, edhe prioritet në procesin e integritimit në BE.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 8 KORRIK - Oda Ekonomike e Kosovës dhe Zyra e Koordinatorës për Zhvillim të OKB-së (UNDCO) kanë nënshkruar të hënën një memorandum bashkëpunimi. Qëllimi i këtij memorandum është të sigurojë një kuadër bashkëpunimi

dhe ta lehtësojë dhe forcojë bashkëpunimin midis palëve, në mënyrë joekskluzive, në fushat me interes të përbashkët. Bashkëpunimi synohet përmes programeve të bashkëpunimit midis palëve për zbatimin e nismave që rrisin aftësitë për punësim të fuqisë punëtore në Kosovë, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë, rrisin produktivitetin e

Punëtorët e Lotarisë së Kosovës kërkojnë ligj nëpërmjet protestës

PRISHTINË, 8 KORRIK - Punëtorët e Lotarisë së Kosovës kanë protestuar të hënën para ndërtesës së qeverisë me kërkesë të miratimit të ligjit për Lotarinë e Kosovës dhe përmbushjen e obligimeve nga ana e qeverisë si pronare e Lotarisë së Kosovës.

Ismet Uka, anëtar i Sindikatës së Lotarisë së Kosovës, ka thënë se kanë dalë në protestën e dytë me kërkesat e njëjta siç është iniciimi i Ligjit për Lotarinë e Kosovës, siç është premtuar, pastaj marrja përsipër e qeverisë të pagave të punë-

torëve të Lotarisë, pasi kjo është kompani publike dhe pronare është qeveria, pastaj mbulimi i shpenzimeve për qiradhënie. Punëtorët e Lotarisë kërkuar zgjidhje sa më të shpejtë të problemit të tyre pasi janë në gjendje të rëndë ekonomike. Pas ndalimit të lojërave të fatit, sipas ligjit të miratuar nga Kuvendi, ku janë përfshirë edhe lojërat e lotarisë, Lotaria e Kosovës e ka ndërprerë veprimtarinë e vet. Edhe javën e kaluar këta punëtorë kanë mbajtur një protestë para qeverisë.



Jashari priti në takim Alketa Mecini, fituese e garës 'Genius Olympiad'

SKENDERAJ 8 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur të hënën në takim nxënësen Alketa Mecini, e cila ka zënë vendin e parë në olimpiadën botërore "Genius Olympiad" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke fituar kështu medaljen e artë në një garë globale me pjesëmarrje nga 70 shtete të ndryshme të botës dhe mbi 1 200 projekte të shkencës, artit dhe teknologjisë.

Kryetari Jashari e ka përgëzuar Alketën për arritjen e saj, duke ia ndarë asaj çekun në vlerë prej 400 eurosh. Jashari ka thënë se nxënësjja Alketa Mecini është shembulli më i mirë dhe konkret se me angazhim dhe përkushtim në mësim dhe punë ëndrrat bëhen realitet. Projekti me të cilin është paraqitur në "Genius Olympiad" paraqet një mënyrë alternative për krijimin e antibiotikëve, duke përdorur bimët mjekë-

sore. Kjo metodë është përdorur në mënyrë që të parandalohet rezistenca ndaj antibiotikëve në trupin e njeriut. Bimë mjekësore që është studiuar ishte "Achyranthes Aspera", e cila gjendet në natyrë me shumicë në kontinentin e Azisë dhe Afrikës.

Alketa Mecini ka qenë nxënëse e shkollës "Shaban Jashari" në Skenderaj, ndërsa tani vijon mësimet në Kolegjin "Mehmet Akif".



Komuna e Mitrovicës do të mbajë gjashtë dëgjime publike për buxhetin e vitit 2020-2022

MITROVICË, 8 KORRIK (ER) - Të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës e cila është drejtuar nga kryetari Agim Bahtiri. Në këtë mbledhje janë diskutuar disa pika të rendit të ditës të cilat janë vlerësuar me interes për qytetarët e kësaj komune.

Fillimisht drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Egzon Jashari, ka prezantuar raportin e punës së komisionit për vlerësimin e kontratave në "Zonën Industriale" në fshatin Frashër. Jashari ka thënë se ky raport është bazuar në doku-



mentacionin e komunës në vendimet e Kuvendit Komunal dhe kontratat duke bërë analizë mbi regjistrimin e drejtës së shfrytëzimit të librat kadastrale si dhe procedurat e lejeve të ndërtimit. Me këtë rast, Bordi i Drejtorëve është pajtuar të ftohen operatorët për një takim të përbashkët dhe të diskutojnë për të gjeturat e këtij raporti. Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka thënë se në bashkëpunim me Policinë e Kosovës më 5 dhe 7 korrik kanë inspektuar lokalet që shkaktojnë zhurmë në orët e vona të mbrëmjes. Ndërkaq drejtori

për Buxhet dhe Financa, Shukri Gashi, ka njoftuar bordin lidhur me orarin e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për projektbuxhetin e komunës për vitin 2020-2022, me ç'rast ka bërë me dije se do të mbahen gjithsej gjashtë dëgjime publike, në të cilat do të marrin pjesë qytetarë, përfaqësues të OJQ-ve, shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve dhe grupeve të tjera të interesat. Ai ka thënë se në këto dëgjime publike të interesuarit do ta kenë mundësinë t'i japin vërejtjet dhe propozimet e tyre për t'u përfshirë në buxhet.

Gjendja me ethe hemorragjike është e qetë në Malishevë

MALISHEVË, 8 KORRIK (ER) - Situata Epidemiologjike me Ethet Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) në Komunën e Malishevës është e qetë dhe nën kontroll. Deri më tani nuk është shënuar asnjë rast i infeksionit me virusin e EHKK, mirëpo shqetësuese për organet përgjegjëse komunale është ndërprerja e fushatës së repelimit të kafshëve, e cila është masa më efektive në luftimin dhe parandalimin e EHKK. Kështu ka deklaruar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili edhe e drejton shtabin komunal për menaxhimin e situatës me EHKK, pas vizitës që i ka bërë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në këtë

komunë, së bashku me drejtorin për Shëndetësi, Liridon Hoti, ku janë njoftuar me gjendjen e rasteve të thumbuara nga rriqrat. Berisha ka bërë me dije se bazuar në të dhënat e QKMF-së në Malishevë dhe të Klinikës Infektive në Prishtinë, deri më tani asnjë rast nga Malisheva nuk është regjistruar i infektuar me virusin e EHKK. "Ky është viti i pestë me radhë që nuk ka raste të infektimit nga ky virus", ka thënë ai. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se repelimi i kafshëve mbetet shqetësim për Komunën e Malishevës.

Në Komunën e Malishevës deri më sot janë thumbuar nga rriqrat 969 persona të cilët janë trajtuar në QKMF në Malishevë.



Asfaltohet rruga 'Gursel e Bajram Sylejmani' në Ferizaj

FERIZAJ, 8 KORRIK (ER) - Komuna e Ferizajt ka bërë asfaltimin e rrugës "Gursel e Bajram Sylejmani", e cila ka qenë në gjendje të keqe. Kjo komunë ka bërë me dije se ndonëse janë përballur me rezistencën e disa banorëve, kryesisht uzurpatorë të pronës publike që kanë vonuar kohën

e realizimit të këtij projekti, pas rregullimit përfundimtar të infrastrukturës nëntokësore, rregullimin e ndriçimit publik dhe njejeve të tjera, të hënën është asfaltuar edhe shtesa e parë e këtij segmenti rrugor, vital për qarkullimin ndërrurban. Për t'i përcjellë nga afër punimet ka dalë edhe

kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, me bashkëpunëtorë. Ai ka thënë se ky investim po nis përfundimin e një bezdie që qytetarëve dhe bizneseve në këtë zonë i pati vështirësuar veprimtarinë dhe qarkullimin e përditshëm. Komunës së Ferizajt kjo rrugë i ka kushtuar rreth 430 mijë euro.



Gjermania, fituesja e kompromisit për Evropën

Pas pesë javësh, Gjermania e Franca ranë dakord për drejtimin e institucioneve qendrore evropiane. Më e fituara në fund doli Gjermania

Auron DODI

Debati për drejtimin e Komisionit Evropian (dhe të Bankës Qendrore Evropiane) mund të konsiderohet i mbyllur. Që prej momentit kur kryetarët e shteteve dhe të qeverive të BE-së propozuan gjermanen Ursula von der Leyen, aktualisht ministre e Mbrojtjes e Gjermanisë, si pasardhëse të Jean-Claude Junckerit, në Komisionin Evropian. Padyshim, këtë vendim duhet ta miratojë edhe Parlamenti Evropian. Kryetari i Këshillit Evropian Donald Tusk e mbrojti në Strasburg para europarlamentarëve kandidaturën e gjermanes. Sipas deklaratave publike të tyre, pritet që socialdemokratët, edhe ata gjermanë, të votojnë kundër von der Leyenit. Këtë e deklaroi publikisht madje edhe kolegja e mëparshme von der Leyenit në qeverinë gjermane, ish-ministria e Drejtësisë së Gjermanisë, socialdemokratja Katarina Barley tashmë eurodeputete. Ish-ministri i Jashtëm, socialdemokrati Sigmar Gabriel kërkoi me këtë rast këtë javë madje fundin e koalicionit qeveritar në Gjermani. Revoltën e shkakton kryesisht fakti se von der Leyeni nuk bëri fushatë evropiane për t'u zgjedhur në krye të Komisionit Evropian. Siç bëri konservatori tjetër, Manfred Weber, të cilin Franca dhe disa vende të tjera e quajtën të papërshtatshëm për postin e Presidentit të Komisionit Evropian.

Goditje e parimit demokratik për hir të paqes në Evropë?

Kështu, sipas kritikëve, emërimi i von der Leyenit e kthen në farsë përpjekjen për t'u dhënë zgjed-

hjeve evropiane një natyrë më demokratike. Në fund të fundit, për von der Leyenin u ra dakord "nëpër zyra".

Po ka pak gjasa që Parlamenti Evropian ta bllokojë, në fund, zgjedhjen e von der Leyenit. Gjithmonë sheh protesta të mëdha nga socialdemokratët dhe pastaj ndodh pak, shkruante revista Der Spiegel këto ditë. Që gjithçka të mos dështojë prej mosmarrëveshjeve brenda gjermane, edhe francezët kanë aktivizuar rrjetet e tyre të miqësisë.

Sipas burimeve franceze, ministri francez i Ekonomisë, Bruno Le Maire kontaktoi ministrin gjerman socialdemokrat të Financave, Olaf Scholz. Ministri i Jashtëm francez Yves Le Drian kontaktoi homologun gjerman socialdemokrat, ministrin e Jashtëm Heiko Maas. Francezët kujtuan përgjegjësinë për Evropën, që do të bllokohej nga një prishje në Gjermani e kompromisit të mundimshëm për postet evropiane.

Kështu që konsiderohet thuajse e sigurt, që Gjermania do të marrë postin me prestigj më të lartë në BE, Presidentin e Komisionit Evropian. Pas gati një gjysmë shekulli, Komisioni Evropian pritet të drejtohet për herë të parë nga një grua. Ursula von der Leyen është nga personalitetet më besnike të Angela Merkelit. Për 14 vjet ajo ka qenë pjesë çdo kabineti Merkel. Dhe tani pritet të drejtojë qeverinë e Evropës. Padyshim arritje për Gjermaninë dhe për kancelaren Merkel.

Çfarë mund të pritet nga von der Leyen si presidente e KE-së?

Emërimi i Ursula von der Leyenit është kompromisi gjermano-francez: që francezët të



merrnin nga ana tjetër, Drejtimin e Bankës Qendrore Evropiane, Bankës përgjegjëse për eurozonën. Christine Lagarde, shefja aktuale e FMN (megjithatë juriste dhe jo ekonomiste) pritet të konfirmohet formalisht në këtë detyrë. Përfaqësuesit e ekonomisë gjermane dhe taksapaguesit gjermanë, që kursejnë para me zell, do ta kishin preferuar për Gjermaninë këtë post. Ulja e normave orientuese bankare të interesit për euron, nga kreu aktual i Bankës Qendrore Evropiane, italianin Mario Draghi, e ka ulur në mënyrë drastike edhe vlerën e kursimeve të gjermanëve në banka.

Ursula Von der Leyen vjen nga një familje me traditë, tregtarësh dhe politikanësh në Gjermani. I ati i saj ka qenë kryeministër i një landi të Gjermanisë. Për një periudhë kohe madje von der Leyeni shihej si pasardhëse e Merkelit, tek CDU-ja.

Si frëngjishtfolëse dhe pro afrimit me Francën në mbrojtje von der Leyeni shihet me simpati edhe nga francezët. Si ministre e mbrojtjes, von der Leyen është treguar e moderuar në kontakte me evropianët dhe e aftë. Kontaktet që ka pasur në post edhe me Ballkanin, i japin asaj njohje më të mirë të gjendjes, se p.sh. Jean-Claude Junckeri.

Sado që Komisioni Evropian mbetet, në fund, ende i pafuqishëm ndaj vendimeve të vendeve anëtare të BE, Presidenti i Komisionit përcakton politikën. Nën drejtimin e von der Leyenit do të jetë edhe Jozep Borelli, i Ngarkuari i Ri për politikën e jashtme të BE. Spanjollin Borell, siç dihet ka shprehur qëndrimin e vendit të tij kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës.

Frans Timmermans, viktima e qëndrimit parimor

Pas skualifikimit të Manfred Weberit, socialdemokrati holandez Timmermans e kishte mbështetjen e Gjermanisë dhe të Francës. Por një politikan parimor si Timmermans mund të konsiderohet viktima e mbrojtjes së parimeve evropiane. Këtu ndizet më tej revolta socialdemokrate në Gjermani. Askush tjetër në Komisionin Evropian nuk e ka mbrojtur më fort sundimin e ligjit në Lindje të Evropës, se zëvendëspresidenti aktual i Komisionit, Timmermans. Sidomos përballë problemeve me shtetin ligjor në Poloni.

Dhe tani qenë pikërisht shtetet me raport "të paretshëm" me ligjin, Polonia dhe Hungaria, brenda Partisë Popullore Evropiane, që nuk e dhanë votën për Timmermansin. Me to u bashkua edhe Italia, që ka aktualisht një qeveri populiste. Në politikën evropiane, me sa duket, kanë sukses vetëm ata që etike-tohen si pragmatikë.

Vetëbesimi francez dhe modestia gjermane

Përballja me shumë shtete ziliqare për fuqinë e Gjermanisë, i ka mësuar politikanët gjermanë të mos flasin shumë, si i kryejnë në fakt punët në politikën evropiane. Edhe në këtë rast ata që shprehen janë francezët.

Sipas shtypit francez qenë francezët që ia kujtuan Merkelit emrin e von der Leyenit, që një vit më parë. E pyetur, kancelarja Merkel nuk e konfirmoi këtë. Po a është meritë franceze suksesit? Në Francë kanë shumë kujdes që Franca të mos

paraqitet si zbatuese e vendimeve të Gjermanisë. Dhe Presidentit Macron i duhet për politikën e brendshme imazhi i njeriut të veprave, që zgjidh probleme. Ky imazh i tij është goditur në Francë, e cila me reformat e tij po përjeton një krizë sociale.

Mot, në vitin 2020 në Francë janë zgjedhjet komunale e edhe për këtë arsye shtypi francez e paraqet Macronin si njeriun pa të cilin nuk funksionon gjë në Evropë. Kjo është ndoshta e vërtetë, por është vetëm gjysma e së vërtetës. Evropa nuk funksionon pa Gjermaninë dhe Francën.

Është fakt që Macroni e goditi parimin e kandidatit kryesor fitimtar, të partive më të mëdha evropiane, të zgjedhjet evropiane. Ai me disa aleatë e pengoi kandidatin e partisë fituese në zgjedhjet evropiane, të Partisë Popullore Evropiane, gjermanin Manfred Weber të bëhet President i Komisionit Sipas Macronit, sistemi i kandidatit kryesor nuk i përgjigjet më kohës.

Por: Presidenti i Komisionit Evropian, vjen nga Gjermania, siç u nis në krye të debatit. Ursula von der Leyen është sërish gjermane, jo franceze apo e ndonjë kombësie tjetër. Ajo është sërish konservatore, politikisht e grupit të Partisë Popullore Evropiane. Macroni tregoi mençuri që evitoi çarjen publike me Gjermaninë dhe i mbeti besnik parimit që kundërshtitë me Gjermaninë ai i shpreh, por privatisht. Po të kishte vepruar ndryshe nuk do të kishte pasur asnjë fitim. As në politikën e brendshme të vendit të tij, ku ai orientohet thuajse për çdo veprim të politikës së jashtme franceze.

(Marrë nga DW)



NË 'KËRKIM' TË

Duke marrë shkas nga një letër drejtuar mikut tim, Ismet Sylejmani, përsiatje për pushtetin, njeriun dhe artin e vështirë të të jetuarit në paqe.

Bedri ISLAMI

Disa ditë më parë, pikërisht me 21 qershor, ju dërgova letrën e mëposhtme, e cila në fakt, mori fillësë nga nderimi që ju ishte bërë, duke i vënë një rrugë emërin e njërit nga prijëtarët e fisit tuaj. Rugët, i dashur mik, janë ata që bashkojnë njerëzit, por edhe mund t'i ndajnë ata. Emëri i një rruge nuk është thjeshtë emërtim, por dëshmi e vlerave. Në të vërtetë, letra ime, erdhi pasi kisha menduar gjatë për pushtetin, njerëzit që e përbëjnë atë dhe artin e vështirë të të jetuarit në paqe.

Në mendje kisha staturën e një lideri të veçantë, i cili, në rrugëtimin e tij politik, gjithnjë u ka dhënë më shumë rëndësi realiteteve konkrete se sa të drejtave abstrakte dhe mundimshëm, ka ngritur një ngrehinë solide të mendimit politik shqiptar, e cila, më shumë se sa nga bashkëkombësit, do të shquhet në vizionin e së ardhmes.

E kisha fjalën për Ali Ahmetin, liderin politik të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Përse e shkrova atë dhe përse tani po shtroj idenë e "kërkimit" të Ali Ahmetit?

**PO E PËRSËRIS
FILLIMISHT TË GJITHË
LETRËN.**

I nderuar mik i dashur dhe i veçantë!

Uroj të jeni mirë të gjithë familjarisht dhe të keni mbarësi.


Në Shqipëri, ku isha pak javë më parë, gjendja është kon-

fuze dhe forcat e vjetra të errësirës janë rizgjuar edhe një herë për të djegur e shkatërruar.

Në Kosovë, po ashtu, e keqja është bërë e pranishme dhe, dhe, çka është më keq, është bërë e pranueshme.

Në Maqedoninë Veriore ka më tepër qetësi, më shumë ecje drejt demokratizimit, megjithëse aty duhej të kishte më tepër probleme dhe unë jam i bindur se, miku ynë i përbashkët dhe drejtuesi i më i lartë politik i shqiptarëve, Ali Ahmeti, luan rolin e tij të pazevend-sueshëm.

Maturia dhe shpirti i tij jashtë konfliktit, siguria për të ecur qetësisht dhe duke e ditur se ku duhet të shkojë në të ardhmen, krijimi i një marrëdhënie të re ndërnacionale, afrimi i shumë intelektualëve drejt përbashkimit, shtrirja e rrjetit të mendimit të lirë drejt njerëzve, koncepti i drejtë për shtetin dhe për Republikën, e kanë bërë praninë e tij të domoshme dhe, përmes pranisë së tij, kanë sjellë për ditë e më shumë staturën e një lideri madhor, jo tipik ballkanik, por european i klasit të parë dhe, në fund të fundit, modelin e një shqiptari të politikës që nuk hedh gurë ndaj të tjerëve, por ngre urat e bashkimit. Jam i bindur se edhe më tej Ali Ahmeti, duke pasur konceptin e drejtë të ndërtimit të shtetit shumë dimensional dhe tejet funksional, do të jetë njeriu i paqes, ashtu si ishte njeriu i luftës. Do të jetë Njeriu që i besoi Fehmi Lladrovci në kohën e luftës dhe do i kishte besuar edhe në këto ditë. Mbetet njeriu që ndërli dhi forcën dhe emrin e Adem Jasharit me një çështje të




madhe dhe që sot, përsëri, do të kishte mbështetjen e tij.

Në mendimin tim nuk mbështetem asnjëherë në miqësinë tonë të përbashkët, në relatat e krijuara nga vitet, pasi për mua, më shumë se çdo miqësi, qëndron kombi dhe e vërteta, qëndron

amaneti i atyre që u flijuan, por, Njeriu i vërtetë, si kam shkruar në njërin nga librat e mi, vazhdon të qëndrojë i vërtetë. Unë e kam ndjekur aktivitetin e tij edhe në ditë të vështira për Lëvizjen, për luftën, për zhvillimin; e kam ndjekur kur pak vetë besonin

se do të kishte një të ardhme të tillë dhe kur shtigjet dukeshin të mbyllura përjetësisht. Pra, njohja jonë më ka shërbyer për të shikuar më gjërë, për të ditur më shumë, për të gjykuar më qetësisht, për të analizuar më thellë, për të përcaktuar më saktë,

ALI AHMETIT



"TË AHMETIT

ër drejtuar mikut tim,
ër pushtetin, njeriun
etuarit në paqe.

EDRI ISLAMI

për t'u përqëndruar më gjërë dhe, sot që po të shkruaj, më vjen keq që në politikën shqiptare të trojeve tona nuk kemi nga një Ali Ahmet në çdo pjesë. Mungesa e një burri shteti në përmasat e tij është mungesë e vlerave dhe këtë e ndjej përditë e më

shumë.

Ju uroj gjithë të mirat, mik i dashur dhe mbarësi! Lajmi për vendosjen e një rruge nën emërin e nderuar të të parëve tuaj dëshmon se nuk keni qenë rastësisht në arad-hën e atyre që iu përkushtuan vendit dhe që luftuan për

një Kosovë të mosvarur, të lirë, dhe me aspiratën e bashkimit të ardhshëm kombëtar".

KJO ISHTE LETRA. NJË DITË MË PARË JU MË KENI SHKRUAR SE:

"Kete leter qe ma keni derguar para disa dite, ne pamundesit qe tua ktheja ashtu si ma don loqka e zemres, une sot, pa lejen Tuaj, por shpresoj se do te ma kishit lejuar, ia kam lexuar Ali Ahmetit, ne praninë e Kryetarit te Parlamentit ge Maqedonise, Talat Xhaferi, te Kryetarit te Drenasit , Ramiz Lladrovciit ,vellait te Heroit te Kombit Fehmi Lladrovci, te Zëvendes Kryeministrit e te Ministrit per Politike te Maqedonise se Veriut, Sadulla Duraku, te deputeteve Xhevat Ademi e Artan Grubi e te personaliteteve te shquara Tahir Hani, Xhevat Zekaj, Bejtullah Ademi, Shaban Ipcja e Hulusi Spahiut!
Ky ishte letërkëmbimi ynë, diçka e zakonshme mes dy miqve.

Më duhet të shtjelloj më tej idenë e " kërkimit" të Ali Ahmetit. Unë e di se ku banon ai dhe mes cilëve banon. Ndoshta i vetmi lider shqiptar që bëri banesën e tij në fshatin e lindjes, në shkallët e së cilës eci për herë të parë Nënlokja AE TIJ.
Por unë jam përtej saj.

Ali Ahmeti është nga ata liderë dhe prej atyre rasteve që vërteton se historia e një kombi mund të kthejë rrugën e saj nga vendosmëria e një njeriu të vetëm.

Zakonisht , vepra e njerëzve të shquar është e qëndrueshme në atë masë sa ata mbajnë parasysh erërat e mëdha të historisë, sa ndikojnë në rriten dhe ecurinë e njerëzve, çfarë përparësie sjellin me veprimet e tyre, cili është vizioni i tyre dhe rrugët e përcaktuara.

Kam ëndërruar gjithnjë që viset shqiptare, pavarësisht se të ndara në shumë pjesë, të kishin një trupë drejtuese, aspak të korruptuar, rë ngjeshur me kulturë elitare dhe ku pushteti të mos kishte

asnjë ndikim mbi ta. Një elitë politike që nuk do të influencuhej as nga joshjet, as nga frikësimet, pjesët e së cilës të ushtronin me kryelartësi privilegjin për të bërë ligje të drejta, të sendërtonin shtetin, të kritikonin dhe të rebelopheshin ndaj një qeverie të padrejtë,dhe, më pas, pasi kishin thënë çfarë mendonin dhe kishin ndërtuar ligje të drejta, të ktheheshin në shtëpi në këmbë,pa frikë, të ruajtur prej mërive nga mbështetja e popullit.

Një elitë e tillë nuk bëhet vetvetiu. Ajo kërkon një lider, vetitë e të cilit të jenë serioziteti dhe besnikëria, të jetë i veçantë dhe i qëndrueshëm, të ngrejë iura dhe jo hendeqe ndarëse, një lider, nga i cili , askush të mos ndashet prej tij pa e ndjerë veten më trim dhe më të aftë për të shërbyer ndaj vendit të tij.

Një lider i tillë është Ali Ahmeti. I pabujë në qëllimet e tij, i qetë në egërsinë e politikës, i hapur kur të tjerët mbyllen, i palirë në robërinë e të tjerëve, i lirë në lirinë e tij; përbuzës për të keqen dhe ndikues i së mirës, i ndodhur shpesh herë në mesin e tallazeve të sulmeve nuk i përdori kurrë ato; i gjendur në fundin e greminës dhe i ngjitur në majën e saj; i parë në hone dhe ngritës urash, njeri i lexuar dhe ngarendës i mendjes para shfrimit të linçimit.

Ndoshta mund të jetë nga njerëzit e sulmuar ashpërsisht, por që nuk e përdori pushtetin për të marrë hakën e tij, por për të marrë hakun e popullit që i takonte dhe këtë, jo përmes sherrit, por mendjes dhe arsyes.

Të gjitha këto që i ka arritur sot , i ka planifikuar në vite të tëra. Që nga fillimi i vitit 1990 e ka ditur se ku do të ishte fundi i tyre; që kur janë ngritur këshillat e parat ë lëvizjes çlirimtare e ka menduar se çfarë do të ndodhë pas çlirimit. Ai e kërkoi gjithë jetën luftën, dhe, kur e gjeti atë, zgjodhi paqen.

Tani, i dashur mik, shiko përballë.

Në Kosovë, ku njëra nga ëndrrat e mia ishte drejtimi i saj nga njerëzit e luftës, më sjell trishtimin. Katër nga

pesë partitë kryesore politike në Kosovë kanë fillësën nga njerëzit e luftës. E megjithatë, pikërisht ata janë ndarëset e mëdha dhe jo bashkueset e mëdha, çka duhej të ndodhte. Miq të dikurshëm, që vinin kokën në supin e shoshoqit tani janë të gatshëm të nxjerrin sytë. Miq të vjetër të provuar në çaste të vështira po kërkojnë krijimin e momenteve të tjera. Mjerisht ndarëse. Nga rjedha e tyre umbet vlera e luftës. Nga pasuria e tyre zvenitet gjaku i derdhur. Nga egoja e pushtetit kthehen në mercenarë. Nga ndarja kthehen në humbës. Nga dëshira për lavdi lënë bosh hapësirat ku vërshon mendimi politik i dëmshëm. Nga debatet e tyre, shpesh herë të shëmtuara përplasen njerëzit e shumë duan arratinë. Çlirimtarët janë të palirë. Shërbëtorët e djeshëm të regjimit shfaqen si patriotë. Dhunuesit e lirisë marrin pamjen e atdhedashësve.

Në shtetin amë, ku kam lindur, egërsia i ka lënë vendin mendimit, liderët janë kthyer në manjatë, oligarkët kanë pushtuar politikën, britmat ndjellin luftën civile dhe kthimin në vitin 1997; britmat e zakonshme janë :bandit, kriminel, vrasës, ta tërheqim zvarrë, ta hedhim në Lanë, ta përmbytim, ditët e numëruara... liderët kanë hapur blloqet e dikurshme dhe po zezojnë Shqipërinë duke marrë nëpër këmbë dinjitetin e saj.

Për fat të keq, as në Kosovë e as në Shqipëri , nuk kemi një figurë rreth të cilit të shkohet me besim, pa drojtje dhe me bindjen se është rruga e duhur.

Pra, i dashur, mungon , ajo që mund ta quajë tani, një figurë e ngjashme me atë të Ali Ahmetit.

Ndaj edhe e " kërkuj " figurën e tij.

Jo si mik. As si dashamir. AJO ËSHTË BRENDA DY NJERËZVE , TË CILËT E KANË PROVUAR MIQËSINË E TYRE.

E KËRKOJ PËR SHUMË MË TEPËR.

Si shembullin e një njeriu që bashkon.

07.07.2019

E jashtëzakonshme

Ishulli skocez ofron 24 473 euro në vit për një bari për dele

Ishulli skocez Ronaldsay ka publikuar një shpallje të pazakontë për vende të lira pune. Kërkohej barinj që do të paguhen mirë që të kujdesen për një lloj të rrallë të deleve - Orkney. Barinjtë, gjithashtu, do të duhet të sigurohen që delet të qëndrojnë sa më larg murit që ndan tokën ku mbillen perimet e ndryshme nga të cilat edhe jetojnë banorët e ishullit. Bëhet fjalë për 35 orë



në javë, ndërsa për një vit paga totale do të jetë 24 473 euro.

FOTO E DITES



Një libian shihet duke bërë sërif elektrik në detin Mesdhe në kryeqytetin e Tripolit. /AFP/

E rrallë

Kina do ta ndërtojë trenin që lëviz me 600 kilometra në orë

Në Kinë është një prototip i trenit, që në mënyrë teorike mund ta arrijë lëvizjen deri në 600 kilometra në orë, falë teknologjisë së njohur si maglev. Sikur planet të përfundohet si janë paraparë, ky tren do të pluskojë në platformën e vet, me shpejtësi marramendëse. Ky tren do të



fillojë të testohet gjatë vitit që vjen, derisa në vitin 2021 pritet të lëvizë me sukses dhe t'i sjellë efektet e duhura.

BARSOLETA E DITËS



Një bionde shkoi te doktori:
- Doktor, dëgjoj zëra, por nuk shoh askënd.
Doktori:
- Kur të ndodhë kështu?
Biondja:
- Sa herë që flas në telefon.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00

“X-Men; Dark Phoenix”

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

“M A”

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Keni marrë përsipër shumë aktivitete njëherësh. Nuk do ta përfundoni asnjërën prej tyre sepse ngarkesa do të jetë e madhe.



DEMI

Një situatë e komplikuar mes kolegësh sot do të marrë një drejtim tjetër. Nëse rrezikoni bashkëpunimin në fund do t'ju fajësojnë juve.



BINJAKËT

Sot duhet të thoni një fjalë të mirë për një person që ju e njihni mjaft mirë dhe që sot do ta kërkojë ndihmën tuaj.



GAFORRJA

Nuk do të mund t'i realizoni sot objektivat tuaja nëse nuk e ndani që në mëngjes programin e ditës. Çdo e papritur penalizon finalizimin e punës.



LUANI

Një gënjeshtëri që ju kanë thënë do të vazhdojë të thellohet edhe më shumë. Kujdes me personat që mbani pranë vetes.



VI RGJËR ESHA

Raportet personale nuk duhet të ndikojnë në ato profesionale sepse do ta prishni punën tuaj. Një çështje delikate ka zënë ditën tuaj sot.



PESHORJA

Surpriza për ditën e sotme do të jetë takimi me një mik që kishit kohë pa e parë. Do të shikoni që koha ka ndaluar dhe këshillat e tij janë gjithmonë të vlefshme.



AKREPI

Keni limitet tuaja në fusha të caktuara dhe do të jetë mirë ta pranoni këtë gjë. Nuk ka asnjë problem nëse kërkon ndihmë kur e shihni të nevojshme.



SHIGJETARI

I keni zgjedhur mjaft mirë kundërshtarët tuaj dhe do të arrini t'i manipuloni deri në çastin që e quani të arsyeshme.



BRICJAPI

Po keqkuptoni afimin e dikujt sot dhe do t'ju duket sikur ka ide të tjera nga ato që ju ka shprehur. Do të kuptoni me kohë se keni gabuar.



UJORI

Herë pas here keni brejtje ndërgjegjeje për veprimet që keni bërë në të kaluarën. Keni kohë për t'i rregulluar situatat nëse i vihen punës.



PESHQIT

Dita do të ketë mjaft lëvizshmëri sa në një çast të caktuar do t'i harroni prioritetet tuaja. Një familjar do të mërzhitet nga kjo neglizhencë.

Konfirmohet lidhja e Shawn Mendesit me Camila Cabellon



Tashmë duket se Shawn Mendes dhe Camila Cabello kanë konfirmuar se janë çift. Këngëtari 20-vjeçar dhe këngëtarja 22-vjeçare janë parë për dorë të dielën në West Hollywood,

Kaliforni. Çifti kishte veshje sportive dhe ndanë çaste romantike gjatë shëtitjes së tyre. Fillimisht u tha se Shawn dhe Camila janë miq të ngushtë, por tani doli se janë lidhur me njëri-tjetrin.

Zbulohet i dashuri i ri i Kendall Jennerit?



Tuhet se Kendall Jenneri është në lidhje me basketbollistin Kyle Kuzma. Modeluesja 23-vjeçare është parë

me të javën e kaluar në Malibu. Kendallli dhe Kyle ishin të shoqëruar nga miqtë në një jaht luksoz për pushime.



Dua Lipa në lidhje me vëllanë e motrave Hadid

Këngëtarja Dua Lipa është parë në krahët e modelit Anwar Hadid dhe tashmë të gjitha hamendësimet u vërtetuan për romancën midis tyre. Dy yjet e shoubizit janë parë së bashku, në një festival në "Parkun Hyde", Londër, duke u përçafuar dhe buzëqeshur si dhe duke ndarë disa puthje me njëri-tjetrin. Kujtojmë se këngëtarja



me origjinë shqiptare, Dua Lipa, i dha fund lidhjes me Isaac Carew, vetëm pak kohë më parë.

Ndahen Eros Ramazzotti dhe Marica Pellegrinelli

Pas një lidhje dhjetëvjeçare Eros Ramazzotti dhe Marica Pellegrinelli janë ndarë. Këtë e ka bërë me dije vetë çifti përmes një komunikate të përbashkët për media. "Kanë qenë dhjetë vjet të mrekullueshëm, së bashku kemi ndërtuar një familje të bukur dhe ishim shumë të lumtur në një mënyrë të paharueshme. Ne jemi të qetë në zgjedhjen tonë të përbashkët dhe do të vazhdojmë të takohemi me njëri-tjetrin shpesh", ka deklaruar çifti për "Ansa". Këngëtari 55-vjeçar dhe modeluesja 31-vjeçare ishin bashkë që nga viti 2009, u martuan në Milano më 6 qer-



shor të vitit 2014 dhe kanë dy fëmijë bashkë, Raffaella Maria tetëvjeçare dhe Gabrio Tullio katërvjeçar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli kërkon rezultat pozitiv në Uells

Feronikeli po synon të marrë një rezultat pozitiv në ndeshjen e parë në Uells ndaj The New Saintsit në mënyrë që ta ketë më të lehtë kualifikimin në ndeshjen kthyesë që zhvillohet në Kosovë. Trajneri Zekirija Ramadani dhe mesfushori Albert Dabiqaj kanë shfaqur optimizëm një ditë para kësaj ndeshje që zhvillohet sonte (e martë) nga ora 20:00



EPOKA E Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kampioni i Kosovës në Futboll, Feronikeli, arriti një sukses historik në Ligën e Kampioneve, pasi u kualifikua në rrethin e parë eliminator të kësaj gare. Skuadra më e mirë në Kosovë për edicionin 2018/2019 ka synime të mëdha edhe në rrethin e parë, pasi synon ta eliminojë The New Saintsin.

Trajneri i kampioneve të Kosovës, Zekirija Ramadani, përfaqëson zyrat e klubit ka thënë se skuadra do ta japë maksimumin për një rezultat pozitiv në Uells, në mënyrë që të jetë më e lehtë për ndeshjen e kthimit që zhvillohet në Kosovë. "Duam ta japim maksimumin për një rezultat pozitiv, pasi do të ishte shumë më mirë për ndeshjen e kthimit. Fusha ku do të zhvillohet ndeshja është me bari artificial, por shpresoj se nuk do të

jetë problem, pasi edhe gjatë javës në Kosovë kemi stërvitur në fushë artificiale", ka deklaruar Ramadani.

Për ndeshjen që zhvillohet sonte (e martë) në Uells foli edhe mesfushori Albert Dabiqaj, i cili është një nga lojtarët më të mirë të klubit nga Drenasi. "Në skuadrën tonë atmosfera si gjithmonë është shumë e mirë. Tash e kemi një kundërshtar të fortë, të cilin e kemi analizuar dhe mund të them se qëndron shumë mirë fizikisht, por ne jemi të përgatitur dhe synojmë ta kalojmë rrethin e parë", ka thënë Dabiqaj për "Epokën e re".

Ndeshja në mes të The New Saints dhe Feronikelit fillon nga ora 20:00. Feronikeli tash është skuadra e vetme që është në garë në Evropë, pasi Prishtina nuk arriti ta kalojë rrethin parakualifikues, duke u mposhtur nga klubi i Gjibraltarit, St Josephs, me rezultatit e përgjithshëm 1-3. Ndeshjen në mes të The New

Saintsit dhe Feronikelit e ka analizuar edhe trajneri Muahrem Sahiti, i cili është ndihmëstrajner në Përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Sahiti ka thënë se shanset për kualifikim në rrethin tjetër janë të barabarta për dy skuadrat. Kundërshtar e radhës e skuadrës nga Drenasi është TNS-ja. Lidhur me shanset e Feronikelit ndaj këtij kundërshtari, Sahiti ka vlerësuar se janë të barabarta. "Tash Feronikeli do të ballafaqohet me një kundërshtar të nivelit më të lartë dhe me përvojë më të madhe, por kam besim se skuadra jonë do të jetë më e përqendruar dhe më e motivuar. Sa i përket kualifikimit, nuk mund të jap prognozë sepse do të jetë shumë vështirë. Do të isha shumë i kënaqur nëse 'Nikli' tregon paraqitje të mirë për faktin se do të ishte një reklamë e mirë për futbollin e Kosovës. Gjasat për kualifikim janë 50 me 50", ka shtuar Sahiti.

SHKURT

Sot varroset Florijana Ismaili

Ish-futbollistja e Zvicrës me prejardhje shqiptare, Florijana Ismaili, do të varroset sot (e martë) në Zvicër. Varrimi i të ndjerës do të bëhet në Worben, Kanton i Bernës, shkruan "Blick.Ch". Lojtarja e Kombëtares së Zvicrës dhe kapitenia e Young Boysit për femra vdiq tragjikisht javën e kaluar në Liqenin e Comos në Itali. Ajo u raportua e zhdukur që nga 29 qershori. Trupi i saj u gjend nga ekipet emergjente italiane në thellësi prej 204 metrash. Raporti përfundimtar i obduksionit sipas, Prokurorisë së Comos, pritet të dalë brenda një muaj.

Drita transferon ish-portierin e Maqedonisë

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, e ka prezantuar përforcimin e ri, Darko Tofiloski. Drita sikurse transferimet e tjera edhe ish-portierin e Maqedonisë e ka prezantuar nëpërmjet një video. 33-vjeçari ka pasur një karrierë të pasur ku ka luajtur për këto skuadra: Pobeda, Schaffhausen, Kosice, Ruzomberok, Dunajska Streda dhe Alashkert.

Muriqi pritet të huazohet në Nottingham Forest

Arijanet Muriqi është portieri numër një te Kosova, por i dyti te Manchester City. Ai kishte disa paraqitje në Carabao Cup, trofe që e fituan në fund "Qytetarët". Muriqi përfitoi nga lëndimi i Claudio Bravos, i cili qëndroi për një vit jashtë fushës së gjelbër. Për t'i dhënë më shumë minuta dhe për të fituar më shumë përvojë, City pritet që ta huazojë portierin e Kosovës te Nottingham Forest, në Championship.

Karateistët rrëmbejnë 9 medalje në Kroaci

Tri medalje të arta dhe gjashtë të bronzta është bilanci i medaljeve të fituara nga karateistët e rinj në Karate 1 Ligën e të Rinjve, të mbajtur në Umag të Kroacisë, prej 5-7 korrik 2019. Komiteti Olimpik i Kosovës përgëzon suksesin e komunitetit të karatesë, duke iu uruar vazhdimësi edhe në garat e ardhshme ndërkombëtare. Fituesit e medaljeve janë Melos Gashi, Benjamin Shabani, Denisa Shabani, Albinot Selmani, Betim Maliqi, Islam Selmani, Gent Peci, Diana Kajtazi, Albrim Samahodaj.

Lullaku kalon te Shakhtyor Soligorsk

Futbollisti shqiptar nga Istogu, Azdren Lullaku, karrierën do ta vazhdojë në Bjellorusi. Ai ka nënshkruar për skuadrën e FC Shakhtyor Soligorsk, kurse pjesë e kësaj skuadre është edhe Elis Bakaj. Lullaku ka shkruar në "Facebook": "Ekipi im i ri në Bjellorusi, zyrtarisht lojtar i Shahtjor Soligorsk". Lullaku ka luajtur për shumë klube gjatë karrierës së tij, kurse për Kombëtaren e Shqipërisë ka realizuar gjashtë paraqitje.

Atletico prezanton transferimin më të shtrenjtë në histori

Atletico Madridi e ka prezantuar Joao Felix, i cili është transferimi më i shtrenjtë në histori të skuadrës spanjolle. Atletico Madridi i pagoi Benficas 126 milionë euro për talentin portugez, i cili do të bartë fanellën me numër 7. "Jam shumë i lumtur që jam pjesë e këtij projekti dhe historisë së këtij klubi. Jam këtu për t'i ndihmuar klubit sa më shumë që të jetë e mundshme. Bashkëlojtarët më kanë pritur shumë mirë", ka thënë 19-vjeçari.

Revanshi Joshua-Ruiz vendoset shumë shpejt

NJU JORK, 8 KORRIK - Eddie Hearn, menaxheri i Anthony Joshua, ka konfirmuar se këtë javë do të zyrtarizohet data dhe vendi se ku do të zhvillohet revanshi mes britanikut dhe meksikanit Andy Ruiz Jr. "Puna e madhe ka nisur, së shpejti do t'i japim të rejtat", shkruan Hearn që po kryen ndërm-

jetësin. Sfida e parë mes dy boksierëve, zhvilluar më 1 qershor në Nju Jork, përfundoi me "KO teknik" në raundin e shtatë nga Ruiz, që mori edhe titullin kampionë bote në peshën e rëndë. Hearn konfirmoi se shanset që dueli të zhvillohet sërish në Amerikë apo në

Britaninë e Madhe janë 50-50. Dueli i dytë mes Anthony Joshua dhe Andy Ruiz Jr do të zhvillohet në muajt e fundit të këtij viti (nëntor ose dhjetor). Ndërkohë, rivalët e tyre, Deontay Wilder dhe Tyson Fury, kanë rënë dakord që revanshin ta zhvillojnë më 22 shkurt të vitit të ardhshëm.



Kloppi mban në ankth Liverpoolin

LIVERPOOL, 8 KORRIK - Në skuadrën e Liverpoolit ka frikë se trajneri Jurgen Klopp mund të vendosë që të mos rinovojë kontratën me kampionët e Evropës. Sipas "The Sun", frika e teknikut gjerman për shëndetin e tij ka bërë që bisedimet e mundshme për rinovimin të frenojnë. "Reds"- at, të cilët e paguajnë ish-teknikun e Borussia Dortmundit me 7 milionë sterlina në vit, kanë ndërmend t'i ofrojnë atij një kontratë të re pas triumfit në Ligën e Kampionëve, duke ia rritur rrogën në 10 milionë paund në vit. John Henry po mendon që t'i ofrojë gjermanit një kontratë 6-vjeçare në "Anfield Road" (60 milionë sterlina) nga frika e një sulmi prej rivalëve të mundshëm që admirojnë gjermanin. Por, sipas "The Sun", 52-vjeçari po lëviz shumë ngadalë e me kujdes dhe do të mendohet mirë përpara se të pranohet të hedhë firmën në një tjetër kontratë. Sipas burimeve të tabloidit, Klopp vlerëson shëndetin e tij përpara karrierës dhe nuk dëshiron ta vendosë veten nën stres të madh, duke firmosur një kontratë të re. Në verën e 2016-s, Klopp dhe stafi i tij teknik firmosën rinovimin e kontratës një vit pas ardhjes në "Anfield", deri në vitin 2022. Ata nuk kanë asnjë



plan që të mos e respektojnë kontratën deri në fund me "Reds"- at. Në fund të sezonit 2021-'22, kur të skadojë marrëveshja aktuale, ai do të ketë mbushur shtatë vjet në stolin e 18 herë kampionëve të Anglisë dhe drejtuesit e klubit kanë frikë se sa më shumë i suksesshëm gjermani të jetë në stolin e të kuqve, aq më tërheqës do të bëhet emri i tij për klubet e interesuara. Kloppi bëri me dije se interesimi i Juventusit dhe Realit të Madridit, përpara se këto klube të firmosnin me Maurizio Sarrin dhe Zinedine Zidane, ishte i pavërtetë. Sezonin

e fundit ish-trajneri i Dortmundit u rikonfirmua në elitën e trajnerëve botërorë, duke ndërtuar një skuadër ëndrrash, e cila ngriti Ligën e Kampionëve të gjashtë në histori, por luftoi deri në fund edhe me Manchester Cityn për titullin kampion, duke regjistruar vendin e dytë (97 pikë) më të mirë në histori. Objektivi kryesor i Kloppit këtë sezon do të jetë ai që t'i japë fund pritjes 29-vjeçare për ta festuar titullin e parë kampion në Angli. Por tifozët e kuq janë të shqetësuar sepse ai po pret më gjatë se parashikimet për të konsideruar të ardhmen e tij.

Hamiltoni zbulon çelësin e suksesit

LONDËR, 8 KORRIK - "Kam fatin e madh që garoj në Formula 1 prej vitesh, çka bën që përvoja mbi shpatulla është e madhe. Në të njëjtën kohë, ndihem në formë të shkëlqyer, fizike dhe psikologjike. Kjo më ka ndihmuar të bëj këtë paraqitje në pistë këtë sezon", u shpreh Lewis Hamiltoni. Piloti britanik i Mercedesit ka fituar 6 nga 9 garat e zhvilluara deri më tani, duke u ngjitur 8 herë në podium dhe kryeson me meritë renditjen e botërorit. "Mendoj se ky është sezoni im më i mirë, të paktën deri më tani. Kurrë më parë nuk e kisha nisur kaq mirë një kampionat", deklaroi Hamilton për "L'Equipe".

Për britanikun çelësi i suksesit është një tjetër. "Durimi. E rëndësishme është që në çdo moment, në çdo garë, në çdo situatë të jesh



i durueshëm dhe produktiv. Në Austri nuk ishim aq të shpejtë, por nuk ka rëndësi, pasi kemi shumë pikë avantazh. Marrim gjërat poz-

itive dhe shohim përpara", ka shtuar Hamiltoni, që ka 31 pikë avantazh karshi shokut të skuadrës, Valtteri Bottas.

SHKURT

Raiola: De Lighti e ka pranuar ofertën e Juventusit

Agjenti Mino Raiola ka thënë se Juventusit ka fituar garën për kapitenin e Ajaxit, Matthijs de Light. Sipas tij, mbrojtësi holandez e ka pranuar ofertën e "Zonjës së Vjetër". "De Light ka pranuar ofertën e Juventusit dhe tash varet nga Ajaxi se si ata do të ballafaqohen me situatën", ka thënë Raiola. "Sky Italia" pohon se Juventusit do t'i paguajë 12 milionë euro në vit, që i bie rreth 230 mijë në javë De Lightit.

Bayerni prezanton Hernandezin

Futbollisti Lucas Hernandez është prezantuar sot në skuadrën e Bayern Munchenit. Gjiganti gjerman i pagoi 80 milionë euro për transferimin e Hernandezit nga skuadra e Atletico Madridit. Ylli francez në skuadrën gjermane do ta bartë fanelën me numër 21, e cila në të kaluarën është mbajtur nga kapiteni Philipp Lahm.

Atletico, 42 milionë euro për Jamesin

Gjatë gjithë javës së kaluar James Rodriguez ka qenë një nga emrat më të përmendur në Spanjë dhe në Itali. Kolumbiani në pronësi të Realit kërkohet nga Napoli me ngulm, por tashmë në lojë fuqishëm është futur edhe Atletico e Madridit. Siç raporton "Il Mattino", Napoli ka mbetur pas në garën me Atletico, kjo pasi madrilet janë gati të bëjnë një ofertë prej 42 milionë eurosh për blerjen e Jmaesit nga Reali. Do të jetë me shumë rëndësi përgjigjja e lojtarit, i cili tundohej nga Napoli, pasi do të jetë nën urdhrat e Carlo Ancelottit, trajner që ka shkuar shumë mirë gjatë periudhës te Reali. Disavantazhi i Napolit në këtë "histori" është se kërkon një vit huazimin e lojtarit dhe më pas blerjen e kartonit të tij.

